



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 39

Datë: 06. 12. 2022. Ora: 18:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Njoftim nga Sekretariati "Raportimet nga KKZ e Komunave Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok".
3. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, pasi paraqiti agjenden e takimit, me 10 vota për u miratue agjenda...

2. **Njoftim nga Sekretariati "Raportimet nga KKZ e Komunave Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok":**

Buraim Ahmetaj, tha se Sekretariati ka vazhduar me funksionalizimin e zyrave në katër komunat veriore të vendit. Gjatë ditë së sotme, katër ushtruesit e tyre të kryesuesve të KKZ fillimisht kanë planifikuar të shkojnë në zyra, në Zubin Potok e në Mitrovicën e veriut, pastaj edhe në Zvečan e Leposaviq. Planifikimi është bërë në kordinim me MPB-në dhe mandej nën përcjelljen e policisë. Vendosja dhe ushtrimi i detyrës së këtyre zyrtarëve, nuk është mundësuar.

Në fillim, në Zubin Potok aty ku ndodhet edhe administrata, punëtorët e atyshëm në panik janë larguar, pastaj është hedhur një mjet shpërthyes (shok bombë). Në ato momente, është dhënë alarmi në qytet. Zyrtari ynë, është siguruar nga policia. Mandej, ka pasur grumbullime të qytetarëve...

Ndërsa, në Mitrovicën e veriut, rreth orës 14:00 zyrtari ynë ka tentuar të vendoset në zyrë por dera e zyrës nuk ishte e mundur të hapet, dhe një dritare ishte e thyer. Pastaj, kanë filluar shpërthime dhe krisma armësh, ndërsa zyrtari ynë është tërhequr. Më vonë, zyra është demoluar...

Të dy këta zyrtarë, kanë bërë raporte. Na informatat e deritanishme, edhe në dy qytetet e tjera ka pasur grumbullime të qytetarëve, por edhe të shtëna...

Kreshnik Radoniqi: A dëshiron të flas dikush...?

Sami Kurteshi: Kjo po dëshmon se Lista Serpska e ka pushtetin faktik në komunat veriore. Ai tha se, KQZ e ka obligim kushtetues organizimin e zgjedhjeve, kurse organet e tjera e kanë detyrim me e garantue sigurinë e gjithë personave, të garantohet lëvizja e lirë, jeta e sigurtë e njerëzve që rrezikohet nga bandat kriminale të armatosura të dërguara, por edhe që janë aty nga Serbia. Këto janë si trupat e Hitlerit që kanë reaguar me dhunë fizike dhe të armatosur ndaj kujtdo që ka qenë kundër...

KQZ, e ka për obligim të kërkoj nga policia siguri dhe mbajtjen e zgjedhjeve...!

KQZ, duhet zyrtarisht të kërkoj nga BE - ja që ti tërheqë vërejtjen qeverisë serbe...!

Z. Kurteshi, u shpreh i indinjuar me gjendjen në veri, dhe potencoi se policia e Kosovës e ka për obligim të garantoj siguri, liri dhe shprehje të vullnetit për të gjithë qytetarët...

Ilir Gashi, kemi diskutuar disa herë por, raportet që kanë ardhë dhe i kemi, tregojnë për një situatë shqetësuese. Ai, tha se sot, ka pasur edhe rrezikim të jetës së zyrtarëve tanë, ndërsa institucionet tona kanë dështuar të krijojnë siguri...

Situata, është më e ndërlikuar se sa që kemi menduar deri më sot, sigurinë duhet ta bëjnë ata që janë të thirrur ta bëjnë, nëse kanë kapacitet ta bëjnë, tha ndër të tjera z. Gashi.

Sami Hamiti, që nga shpallja e zgjedhjeve e kemi diskutue këtë çështje, por prej fillimit është neglizhuar, edhe 12 ditë është dita e zgjedhjeve...Nuk kemi dramatizue, por prej përvojës e kemi...! Është momenti i fundit që të bisedohet, saktë të kërkohet me gjithë institucionet se si, do të shkohet tutje...Nuk mund të shkoj zyrtari ynë, nuk është i siguruar. Ne, nuk duhet ti qojmë e tua rrezikojmë jetën...

Arianit Elshani, tha ndër të tjera se, është bërë rrezikimi i jetës së zyrtarëve tanë, prandaj duhet të kemi koordinim me MPB që qytetarëve të këtyre komunave tu ofrohet siguri. Është e nevojshme që, të dy palë zgjedhjet të shkojnë mirë...Ne, kemi përfunduar gati aktivitetet, nesër është edhe shorti për subjektet politike në këto komuna, tani është e nevojshme të kemi edhe një angazhim të institucioneve tjera...

Alim Rama, tha se, na si KQZ duhet mu sigurie në punët tona. Sigurisht, organet tjera i përcjellin – i kryjnë punët e veta. Dje, e kemi kutpue se ka pas ni dakordim, dhe u dakordu sot. Nuk po po shoh që ka pas ni vonesë, por dhuna në zgjedhje nuk është e tolerueshme. Nuk ka rrugë të shkurtë me marrë pushtetin, e metmja rrugë për pushtet kalon nëpër zgjedhje... Kështu, unë kërkoj që të mbështetet kërkesa e z. Kurteshi që KQZ ti dërgoj letër BE, KFOR-it... Ne, të fokusohemi në punët tona, tha ndër të tjera z. Rama.

Čemajl Kurtiši, tha se pajtohet me fjalët e kolegëve, por ai konstatoi se situata është delikate, dhe tash e paparashikueshme. Sonte, ish dashtë të ketë takime në institucionet tjera, dhe ne të kishim dërguar mesazhet...sepse, nuk jemi ne problemi por problemi është siguria, njerëzit janë të frikësuar atje...E kemi të qartë, ata janë të frikësuar dhe njerëzit as nuk mund të votojnë kështu! Seriozisht duhet kuptuar situatën, ne mund të flasim deri nesër por situata është serioze, tha ndër të tjera z. Kurteshi.

Sami Hamiti, tha se zgjedhje mbajmë në veri, jo në Prishtinë. Situata është e brishtë, neglizhnca ka qenë e dukshme...Ne po flasim për siguri ! Si të votojmë kur s'ka siguri. Kërkuesat KFOR-it duhet ti bajënë organet tjera, jo ne...

Ilir Gashi, tha se nuk është problem plani, por siguria ! Me institucionet tjera ndërkombëtare, kontaktojnë organet tjera. Jo ne, se nuk e kemi këtë autoritet...! Z. Gashi, tha se nga dita e nesërme ne do të ballafaqohemi me dicka tjetër: ndoshta me dorëheqjen e KKZ-ve, të KVV-e, cka do të bëjmë ne, a do t'arrijmë me i zëvendësue...? Cilat janë alternativat...? Këto janë sfidat tona. E për me i realizue, duhet të kemi siguri...

Arianit Elshani, tha se, janë proceset e tjera: shorti, fushata, procesi i trajnimit të komisionerëve...? Ky veprim i sotëm, ka qenë në koordinim me policinë por, a kemi siguri...? Askush nuk po e vë në dilemë, zgjedhjet duhet me u mbajtur, por a ka siguri...?

Sami Kurteshi: Po më duket si tautologji një pjesë e diskutimeve ! Ne e kemi një plan operacional, por ne duhet të kërkojmë nga policia e Kosovës që të krijohet siguria...Për shkak të veprimeve të sotme, ne duhet me nxjerrë një komunikatë zyrtarisht që ti kërkohej Serbisë që ti tërheqë trupat e armatosura, grupet e armatosura, se është një parti politike Lista Serbe që po përpiqet ta dëshmojë se ajo e mban pushtetin dhe jo tjetërkush...! Kjo kërkesë e KQZ për BE dhe KFOR nuk ka tjetër kuptim, veq që ti kryjnë obligimet e tyre...

Nëse ne nuk e bëjmë këtë kërkesë, ne po heqim dorë nga zbatimi i planit tonë operacional...!

Ne si institucion jemi të interesuar dhe të obliguar që të bëjmë zgjedhje të lira, tha ndër të tjera sërish z. Kurteshi. Ai, krahasoi grupet e armatosura serbe në veri, me ato SS të Hilerit...!

Burim Ahmetaj, tha se në raportin e parqaitur kemi qenë në koordinim me policinë, por sot jemi penguar në ushtrimin e detyrës zyrtare. Tash, jemi në fazën e nominimit të këshillave, dhe duhet ti kemi trajnimet. S'janë më vetëm 4 zyra, por janë trupat zgjedhore 44 Qendra Votimi dhe në 86 Vendvotime...! Rreth 500 veta duhet të sigurohen...

Kreshnik Radoniqi: Sa po shoh unë, në këto kushte sipas planit tonë nuk mund të punojmë! Është e padrejtë me i dërgue zyrtarët tanë, ndërsa kemi pas komunikim me policinë... Por, po shihet se është problematike...Qasja, është shumë problematike... Ne do ta marrim një raport nga policia – të tërësishëm, ne me zor zgjedhje nuk mund të bajmë...në ditët në vijim do të shohim...! Për punët tona, ne jemi të gatshëm...

Ama, atë që kemi pa sot, qasja jonë në veri është e limitueme...

Mw tej, diskutuan: Alim Rama, Ilir Gashi, Sami Kurteshi dhe Kreshnik Radoniqi.